



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

PROJEKTLIGJ

Nr. _____/2023

**PËR
SIGURIMIN E DETYRUESHËM TË BANESAVE NGA TËRMETET**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Objekti**

Ky ligj përcakton rregulla dhe norma për sigurimin e detyrueshëm të banesave nga tërmetet në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 2
Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është mbulimi humbjeve financiare të pësura nga i siguruari për shkak të dëmeve të drejtëpërdrejta të ndodhura në pasurinë e siguar, të shkaktuara nga ngjarjet e tërmetit sipas kritereve të përcaktuara me këtë ligj.

**Neni 3
Fusha e zbatimit**

1. Sigurimi i detyrueshëm i banesave nga tërmetet zbatohet për llojet e mëposhtme

të pronave të paluajtshme:

- a) banesa;
 - b) seksionet që ndodhen brenda banesave që përdoren si njësi shitje, zyra apo për qëllime të ngjashme.
2. Pronat e përcaktuara në pikën 1 , të këtij neni, në vijim referohen “prona të sigurueshme”.
3. Pavarësisht parashikimeve të paragrafit 2, të këtij neni, sigurimi i detyrueshëm i banesave nga tërmetet nuk zbatohet për pronat e mëposhtme:
- a) ndërtesat të cilat përbëhen nga argjile/qerpiç, strukturë me fibër - kallami ose të ngjashme;
 - b) ndërtesa me vendosje të lëvizshme ose të përkohshme.

Neni 4

Përkufizimet

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a. “Subjekti që ka detyrimin për të paguar primin”- individ, person fizikë ose juridik, vendas apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave.
- b. **Sigurim i detyrueshëm i banesave nga tërmetet**”: nënkupton subjekti që ka detyrimin për të paguar primin, për të lidhur një kontratë sigurimi me qëllim mbulimin e humbjeve financiare brenda shumës së sigurimit, si rezultat i dëmeve të ndodhura drejtpërdrejta në banesa, për shkak të tërmeteve. Për qëllime të këtij ligji, në vijim, “sigurimi i detyrueshëm i banesave nga tërmetet”, shkurt do të referohet “sigurimi i detyrueshëm nga tërmetet”.**Banesë**”: nënkupton një ndërtesë rezidenciale ose pjesë të një ndërtese rezidenciale, që përdoret për qëllime banimi nga një ose më shumë persona. Banesa nuk përfshin tokën që ndodhet nën strukturën e banesës edhe nëse kjo shërben për mbështetjen apo instalimin e saj. Banesa nuk përfshin ndonjë strukturë përveç strukturës rezidenciale me përjashtim të rasteve kur struktura ndan një mur të përbashkët ose një çati në vazhdimësi me strukturën rezidenciale ose shtëpinë lëvizëse ose është ngjitur me strukturën rezidenciale ose shtëpinë lëvizëse përmes një

- themeli i cili është në vazhdimësi të themelit me strukturën rezidenciale.
- c. **Banesë sociale me qira**” është banesa që jepet me qira, në pronësi publike, nga fondi publik i banesave sociale, si dhe banesat që janë e mbeten në pronësi të subjekteve private, por që vihen në dispozicion të programit të banesave sociale me qira, me pëlqimin e pronarit privat.
 - d. **Tërmet**”: nënkupton një fenomen natyror i cili shkakton krijimin e valëve sizmike të shkaktuara nga dridhjet ose zhvendosje të tokës ose edhe me krijimin e dallgëve detare.
 - e. **Ngjarje tërmeti**”: nënkupton një tërmet me magnitudë 5.0 ose më të lartë të shkallës rihter i cili ka ndodhur në Republikën e Shqipërisë ose rajonet ngjitur dhe ka sjellë dëme në Shqipëri, i raportuar nga Autoriteti Kombëtar i autorizuar të masë tërmetet. Vlerësohen pjesë e ngjarjes së tërmetit, të gjitha tërmetet pasuese (paslëkundjet - *aftershocks*) si dhe zjarri, shpërthimi, rrëshqitjet e tokës apo ulje (zhvendosje) të shkaktuar nga lëkundjet pasuese, që ndodhin gjatë një periudhe kohore prej 72 (shtatëdhjetë e dy) orësh nga zhvillimi i ngjarjes së tërmetit.
 - f. **“Rrëshqitje toke”**: nënkupton një fenomen gjeologjik të shkaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga një ngjarje tërmeti e cila përfshin një rreze të gjerë të lëvizjes së tokës si rënie shkëmbinjsh, rrëzimi i skarpateve dhe prurjeve të mbeturinave në sipërfaqe të cekëta.
 - g. **“Zhvendosje e tokës”**: nënkupton lëvizje të sipërfaqes së tokës (zakonisht sipërfaqja e Tokës) që për shkak të një tërmeti zhvendoset poshtë krahasuar me nivelin e detit.
 - h. **“ Pjesa e zbritshme”**: nënkupton atë pjesë të dëmshpërblimit që përballohet nga vetë i siguruari dhe i zbritet vlerës së dëmshpërblimit në rast të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit.
 - i. **YRP – Periudha e kthimit**”, e njohur edhe si interval përsëritjeje: nënkupton një vlerësim të mundësisë së ndodhjes të një ngjarje tërmeti.
 - j. **“Humbje e mundshme maksimale për një periudhë të caktuar kthimi”**: Humbja e mundshme maksimale për një periudhë të caktuar të kthimit në “*n*” vite është niveli i pragut të vlerës përtej të cilës humbjet e shkaktuara nga një ngjarje e madhe tërmeti me një probabilitet ngjarje

në një vit të caktuar 1/ 'n' është pothuajse i pamundur.

k. Për qëllime të këtij ligji, në vijim, "**Fondi Kombëtar për Sigurimin e Detyrueshëm nga Tërmetet**", shkurt do të referohet "**Fondi Kombëtar për Tërmetet**".

1. "**Polica e sigurimit të detyrueshëm**"

Kreu II

SIGURIMI I DETYRUESHËM NGA TËRMETET

Neni 5

Detyrimi për Sigurim

1. Subjekti i sigurimit detyrohet të blej police të sigurimit të detyrueshëm nga tërmetet në përputhje me dispozitat e këtij ligji, si dhe të kryejnë rinovimin e saj çdo vit.
2. Detyrimin për blerjen e policës së sigurimit nga tërmetet e kanë edhe subjektet e banesave sociale me qera, përfshirë banesat në proces legalizimi, si edhe njësitë e vetqeverisjes vendore, të cilët financojnë primin nga buxheti i tyre.
3. Buxheti i shtetit financon primin e sigurimit të detyrueshëm nga tërmetet për shtresat sociale në nevojë.
4. Kriteret dhe procedurat për financimin nga sigurimi i detyrueshëm i tërmeteve për shtresat sociale në nevojë, nga buxheti i shtetit dhe buxheti i vetqeverisjes vendore tek Fondi Kombëtar për Tërmetet, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6

Mbulimet dhe përjashtimet e policës së sigurimit të detyrueshëm nga tërmetet

1. Polica e sigurimit të detyrueshëm nga tërmetet mbulon dëmet e ndodhura në pronën e siguruar, të shkaktuara nga një apo disa ngjarje tërmeti të ndodhura gjatë periudhës së vlefshmërisë së përcaktuar në policë.
2. Përjashtohen nga mbulimi i sigurimit të detyrueshëm nga tërmetet:
 - a) të gjitha lëndimet trupore duke përfshirë edhe vdekjen;

- b) kërkesa për kompensim të dëmeve morale;
- c) sendet brenda banesës së objektit të siguruar;
- d) shpenzimet në lidhje me heqjen dhe zhvendosjen e mbeturinave;
- e) humbjet financiare nga ndërprerja e biznesit dhe fitimi i munguar.

Neni 7

Shuma e sigurimit

1. Shuma e sigurimit, sipas këtij ligji, është limiti maksimal i dëmshpërblimit.
2. Shuma e sigurimit është e barabartë me kufirin e saj të detyrueshëm, i cili përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Bordit Drejtues të Fondit Kombëtar të Tërmeteve, nëpërmjet ministrit përgjergjës për financat.
3. Pjesa e zbritshme është në nivelin e 2 (dy) përqind të vlerës së dëmit dhe mbulohet nga subjekti i siguruar për çdo dëm që shkaktohet nga ngjarjet e tërmetit të mbuluara nga sigurimi i detyrueshëm ndaj tërmeteve.

Neni 8

Primi i Sigurimit

1. Primi i sigurimit është shuma që paguhet për marrjen e mbulimit të sigurimit sipas këtij ligji.
2. Primi i sigurimit paguhet nga subjekti i siguruar si pagesë e plotë.
3. Niveli i primit duhet të llogaritet me metodologji aktuariale, bazuar në modelin e rrezikut nga tërmetet të zhvilluar për Shqipërinë, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, mbas marrjes së mendimit të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare. Në përcaktimin e primit të sigurimit, ndër të tjera, duhet të merret në konsideratë, humbja e mundshme maksimale për periudhën e caktuar të kthimit, shpenzimet e lidhura me cedimin në risigurim si dhe shpenzimet e tjera operative të Fondit Kombëtar të Tërmeteve.

Kreu III

POLICA E SIGURIMIT

Neni 9

Polica sigurimit

1. Polica e sigurimit është e vlefshme nëse është paguar pranë agentëve të shitjes, si dhe në mënyrë elektronike në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Polica e sigurimit duhet të përmbajë të paktën elementët e mëposhtëm:
 - a) emrin dhe të dhënat mbi pronën e të siguruarit dhe Fondit Kombëtar për Tërmetet;
 - b) objektin e policës
 - c) rreziqet e mbuluara dhe përjashtimet ose kufizimet nga mbulimi;
 - d) datën e fillimit dhe mbarimit të policës së sigurimit;
 - e) shumën e siguruar;
 - ë) primin e sigurimit.
4. Periudha e vlefshmërisë së policës së sigurimit të detyrueshëm nga tërmetet është një vit.
5. Polica e sigurimit të detyrueshëm nga tërmetet hyn në fuqi në orën 24:00 të datës së shënuar në kontratën e sigurimit dhe përfundon në orën 24:00 të datës së shënuar në kontratën e sigurimit si datë e përfundimit të saj. Nëse primi ose kësti respektiv nuk paguhet në kohë, sigurimi pezullohet deri në orën 24:00 të ditës kur paguhet primi.
5. Kushtet e përgjithshme të policës përcaktohen me rregullore të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare.

Neni 10

Vlerësuesit

1. Për vlerësimin e dëmeve të shkatuara nga një ngjarje tërmeti, Fondi ka të drejtë të kontraktojë ekspertëve të licencuar.
2. Në rast kur një ngjarje tërmeti ka përmasa të konsiderueshme, në të cilën vlerësimi i dëmeve nuk mund të realizohet nga gjithë ekspertet e licencuar në Republikë të Shqipërisë, Fondi pajton edhe ekspert të fushës të inxhinierëve dhe arkitekturës të Institucione të Arsimit të Lartë ose Shoqatave, Enti Kombëtar i Banesave, dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe institucione të tjera në këtë fushë që kanë njohuritë e duhura për vlerësim.

Neni 11

Pagesa e dëmshpërblimit

1. Vlera e dëmshpërblimit për dëme që rrjedhin nga polica e sigurimit të detyrueshëm nga tërmetet nuk kalon në asnjë rast limitin maksimal sipas metodologjisë të dëmshpërblimit të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. I siguruari është përgjegjës për paraqitjen e kërkesës për dëmshpërblim pranë Fondit Kombëtar për Tërmetet.
3. Rregullat dhe procedurat për pagesën e dëmeve përcaktohen me rregullore të Bordit Drejtues të Fondit Kombëtar për Tërmetet, e cila botohet në Fletoren Zyrtare.
4. Dëmshpërblimi paguhet brenda nëntë muajve.
5. Procedura dhe pagesa e dëmshpërblimit kryhet nëpërmjet një agjenti të autorizuar, të përcaktuar me udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat.
6. Përfituesi i dëmshpërblimit me vullnetin e ti mund të transferoj vlerën e dëmshpërblimit e tij pranë fondit të rindërtimit i cili krijohet me ligj të veçant që rregullon rindërtimin nga pasojat e tërmetit.

Neni 12 **Ankesat**

1. Çdo subjekt i siguruar , ose përfaqësuesi ligjor i tyre ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë Fondit Kombëtar për Tërmetet në rast mos respektimi të kushteve të policës së sigurimit të detyrueshëm nga tërmetet, dhe rregullave të këtij ligji.
2. Bordi Drejtues miraton rregullore të brendshme për shqyrtimin e ankesave.
3. Fondi Kombëtar për Tërmetet i përgjigjet çdo ankese të depozituar me shkrim apo në formë elektronike, brenda 15 ditëve pune nga data e marrjes së ankesës.
4. Vendimet që merr Fondi Kombëtar për Tërmetet lidhur me shqyrtimin e ankesave ankimohen pranë Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare, i cili e shqyrton kërkesën brenda 15 ditëve.
5. Nëse ankesa nuk pranohet nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare plotësisht ose pjesërisht , subjekti ka të drejtë të ankohet në gjykatën civile të juridiksionit të zakonshëm.

Kreu IV

FONDI KOMBËTAR NGA TËRMETET

Neni 13

Fondit Kombëtar për Tërmetet

1. Fondi Kombëtar për Tërmetet (në vijim fondi) krijohet si person juridik , i organizuar në formën e një shoqërie aksionare, sipas këtij ligji, dhe ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.
2. Autoriteti Publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të Fondit, është ministri përgjegjës për financat.
3. Fondi ka pavarësi operacionale dhe financiare, në zbatim të dispozitave të këtij ligji.
4. Fondi ka logon dhe vulën e tij, të cilat miratohen nga Bordi Drejtues.
5. Fondi përjashtohet nga tatimi mbi të ardhurat dhe taksat kombëtare
6. Fondi shpërndahet dhe likuidohet me ligj.

Neni 14

Financimi dhe shpenzimet

1. Fondi financohet nga :
 - a) policat e sigurimit;
 - b) komisionet e marra nga transaksionet e risigurimit;
 - c) të ardhurat nga investimi;
 - ç) buxheti i shtetit
 - d) të ardhura të tjera të ligjshme si grante dhe donacione.
2. Fondi i shpenzon të ardhurat për:
 - a) pagesa të dëmshpërblimeve dhe shpenzime për trajtimin e dëmeve;
 - b) pagesa të komisioneve për shitjen e policave të sigurimit të detyrueshëm nga tërmetet;
 - c) pagesa për risigurim;
 - d) shpenzime operative të Fondit;
 - e) pagesa e tarifës së shërbimit në rast të delegimit të një apo disa funksioneve të Fondit.
 - f) transferta pranë fondit te rindërtimit i cili krijohet me ligj të veçant që rregullon rindërtimin nga pasojat e tërmetit.
3. Të ardhurat e mbetura pas përballimit të shpenzimeve të përcaktuara në këtë nen i trashëgohen Fondit.

Neni 15

Përgjegjësitë e Fondit Kombëtar për Tërmetet

1. Fondi Kombëtar për Tërmetet është përgjegjës për:
 - a) shitjen e policave të sigurimit;
 - b) administrimin e primeve të sigurimit të detyrueshëm nga tërmetet;
 - c) krijimin e përfitimeve nga investimi i të ardhurave nga policat e sigurimit;
 - d) risigurimin e primit;
 - e) trajtimin dhe pagesën e dëmeve që mbulohen nga polica e sigurimit të detyrueshëm nga tërmetet;

2. Fondi siguron që në veprimtarinë e tij të mbështetet në një sistem elektronik sipas legjislacionit në fuqi për bazën e të dhënave shtetërore , i cili të paktën garanton:
 - a) shitjen e policave të sigurimit të detyrueshëm nga tërmetet;
 - b) regjistrimin e të dhënave të subjekteve, pagesave të primit, përcaktimi i primit dhe dëmet
 - c) monitorimin e vazhdueshëm të akumulimit të rrezikut të sigurimit nga tërmetet dhe vlerësimin e dëmeve të pritshme përmes zhvillimit dhe përdorimit të modeleve të rrezikut të sigurimit nga tërmetet dhe modelit të rrezikut të zhvilluar për Shqipërinë.

Neni 16

Organizimi, funksionimi dhe përgjegjësitë e Fondit Kombëtar për Tërmetet

1. Veprimtaria e Fondit Kombëtar për Tërmetet drejtohet nga Bordi dhe Drejtori Ekzekutiv dhe mbështetet nga një administratë, që funksionon në përputhje me rregulloren e brendshme të përshkrimit të punës dhe me rregulloret e tjera për funksionimin e administratës, të cilat miratohen nga Bordi Drejtues.

2. Marrëdhëniet e punës për punonjësit e Fondit Kombëtar për Tërmetet rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës dhe të akteve të Fondit Kombëtar për Tërmetet.

Neni 17

Organet e Fondit

Organet e Fondit janë:

1. Asambleja e Përgjithshme
2. Bordi Drejtues
3. Drejtori Ekzekutiv

Neni 18
Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme merr vendim për :

- a) miratimin e statusit të fondit dhe ndryshimin e tij;
- b) miratimin e strategjisë së zhvillimit;
- c) çështje të tjera sipas ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

Neni 19
Bordi Drejtues

1. Organ mbikqyrës i Fondit Kombëtar për Tërmetet është Bordi, i cili përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët emërohen nga ministri përgjegjës për financat, me përfaqësuar si më poshtë:
 - a) dy anëtar nga Ministria përgjegjëse për financat, ku një prej të cilëve është edhe Kryetar i Bordit Drejtues;
 - b) një anëtar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;
 - c) një anëtar nga struktura përgjegjëse për emergjencat civile;
 - d) një nga shoqatat shqiptare e sigurimeve;
2. Antarët e Bordit emërohen me një mandat 3 vjeçar, me të drejtë rizgjedhje, vetëm njëherë.
3. Në rastet kur mandati i anëtarit ka përfunduar, secili prej tyre qëndron në detyrë deri në çastin e zgjedhjes së anëtarëve të rinj, por jo më shumë se tre muaj. Tre muaj para përfundimit të mandatit të çdo anëtari të Bordit Drejtues, ministria përgjegjëse për financat njofton me shkrim institucionin përkatës propozues.
4. Ministri përgjegjës për financat refuzon kandidaturat për anëtarë të bordit drejtues nëse kandidati nuk plotëson kriteret e parashikuara në këtë ligj.
5. Rregullat për organizimi dhe funksionimin e bordit miratohet me vendim të Bordit Drejtues.

Neni 20
Kriteret për t'u emëruar anëtar i Bordit Drejtues

1. Anëtarët e bordit drejtues duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:
 - a) të jenë shtetas të Republikës së Shqipërisë;
 - b) të mos jenë të dënuar;
 - c) të kenë diplomë universitare dhe pasuniversitare në ekonomi (financë/kontabilitet), drejtësi ose shkencë aktuariale;
 - d) të kenë jo më pak se 5 vjet përvojë profesionale në nivel drejtues, në fushat:
 - i. sigurim/risigurim;
 - ii. financa publike;
 - iii. administrim/ mbikëqyrje të tregjeve financiare, tregjeve të kapitalit;
2. Ministri përgjegjës për financat vlerëson nëse një person është i përshtatshëm dhe ka aftësi për të mbajtur pozicionin përkatës si anëtar i bordit drejtues dhe drejtor ekzekutiv, bazuar në kriteret e mëposhtme:
 - a) integriteti, ndershmëria dhe përkushtimi në përmbushjen e funksioneve të tij;
 - b) kompetenca, aftësia profesionale dhe gjykimi i shëndoshë në përmbushjen e funksioneve të tij;
 - c) pavarësia, në mënyrë që të mos cenohen interesat e Fondit Kombëtar për Tërmetet nga konflikti i interesit që mund të krijohet gjatë ushtrimit të detyrës.
3. Anëtarët e bordit dhe drejtori ekzekutiv nuk duhet:
 - a) të kenë qenë, në 10 (dhjetë) vitet e fundit, ortak apo anëtar i një organi drejtues ose kontrollues, apo administrator i një subjekti, për të cilin janë hapur procedurat e falimentimit. Afati 10-vjeçar fillon nga data e vendimit të gjykatës për hapjen e procedurave të falimentimit;
 - b) të mos ketë qenë në 10 (dhjetë) vitet e fundit ortak apo anëtar i një organi drejtues ose kontrollues, administrator i një subjekti, për të cilin janë vendosur procedurat e administrimit të përkohshëm. Afati 10-vjeçar fillon nga data e njoftimit të aktit për vendosjen e procedurave të administrimit të përkohshëm;
 - c) të mos ketë pasur në 10 (dhjetë) vitet e fundit pozicione drejtuese apo kontrolluese në një subjekt tregtar ose institucion financiar, të cilit i është hequr e drejta për të ushtruar një veprimtari të caktuar tregtare ose financiare brenda apo jashtë vendit;
 - d) të mos i jetë refuzuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare/Banka e Shqipërisë në 10 vitet e fundit kërkesa për t'u bërë anëtar i këshillit të mbikëqyrjes/administrimit të një subjekti, veprimtaria e të cilit është objekt i mbikëqyrjes nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare/Banka e Shqipërisë.
 - e) të mos ketë qenë ose të mos jetë subjekt i procedurave të deklarimit të paaftësisë paguese të detyrimeve ndaj të tretëve.
 - f) të mos ketë qenë i dënuar penalisht, me vendim gjykate të formës së prerë.

4. Kërkesat për përshtatshmëri dhe aftësi, të përcaktuara në këtë nen, duhet të përmbushen gjatë gjithë kohës që anëtarët janë në detyrë.

Neni 21

Lirimi nga detyra e anëtarëve të Bordit

1. Lirimi nga detyra i anëtarëve të Bordit Drejtues ndërpritet përpara afatit të parashikuar në rastet kur:
 - a) largohet nga institucioni që përfaqëson;
 - b) jep dorëheqjen;
 - c) bëhet fizikisht i paaftë për të përmbushur detyrën, për të cilën është emëruar, për më shumë se 3 muaj;
 - d) mungon pa arsye në më shumë se tre mbledhje radhazi;
 - e) gjatë ushtrimit të funksioneve vepron në kundërshtim me detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit;
 - f) për shkak të paaftësisë profesionale apo neglizhencës i shkakton dëm Fondit Kombëtar për Tërmetet;
2. Në rast të liritimit nga detyra të ndonjërit prej anëtarëve të Bordit Drejtues përpara afatit, anëtari tjetër emërohet me të njëjtën procedurë, siç është emëruar anëtari që lirohet, për periudhën deri në përfundim të mandatit të anëtarit që lirohet.

Neni 22

Përgjegjësitë e Bordit Drejtues

1. Bordi Drejtues ushtron në mënyrë të pavarur këto kompetenca:
 - a) miraton rregulloren për trajtimin e pagesës dhe ankesës për dëmshpërblim;
 - b) miraton rregulloren për krijimin, investimin, dhe alokimet e përdorimin e fondit të rezervës;
 - c) miraton rregulloren mbi strukturën organizative, përshkrimin e punës dhe organizimin dhe funksionimin e Fondit Kombëtar për Tërmetet;
 - d) miraton pagën, shpërblimet si dhe trajtimet financiare të anëtarëve joekzekutivë të Bordit Drejtues, Drejtorit Ekzekutiv si dhe të punonjësve;
 - e) miraton politikën e burimeve njerëzore dhe rregullat e punësimit;
 - f) miraton pasqyrat financiare të Fondit Kombëtar për Tërmetet;
 - g) miraton raportin vjetor të veprimtarisë së Fondit Kombëtar për Tërmetet për vitin e mëparshëm, dhe e paraqitet tek Ministri përgjegjës për financat;
 - h) ushtron çdo kompetencë tjetër dhënë me këtë ligj dhe me legjislacionin në fuqi.

2. Për qëllime të mbikëqyrjes së operacioneve teknike të Fondit Kombëtar për Tërmetet, Bordi Drejtues mund të krijojë komisione ekspertësh dhe kur është e nevojshme mund të përfshihen edhe anëtarët e Bordit.

Neni 23

Drejtori ekzekutiv

1. Drejtori Ekzekutiv emërohet nga Bordi Drejtues pas një procedure përzgjedhëse e cila miratohet me vendim Bordi.
2. Përveçë kritereve të përvaktuara në nenin 17, pika 2 dhe 3 e këtij ligji, Drejtori duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:
 - a. të mos jenë të dënuar;
 - b. të kenë diplomë universitare dhe pasuniversitare në ekonomi (financë/kontabilitet) ose shkencë aktuariale;
 - c. të kenë jo më pak se 10 vjet përvojë profesionale në nivel të lartë drejtues, në fushat:
 - iv. sigurim/risigurim;
 - v. administrim/mbikëqyrje të tregjeve financiare;
 - vi. tregjeve të kapitalit;
 - vii. sipërmarje e investimeve kolektive.

Neni 24

Përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv

1. Drejtori Ekzekutiv i Fondit Kombëtar për Tërmetet organizon dhe administron veprimtarinë e përditshme të Fondit.
2. Drejtori Ekzekutiv i Fondit Kombëtar për Tërmetet ka këto kompetenca:
 - a. përfaqëson Fondin Kombëtar për Tërmetet;
 - b. organizon, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e administratës;
 - c. përgjigjet para Bordit Drejtues për zbatimin e vendimeve të miratuara;
 - d. i propozon Bordit Drejtues çështjet që duhen përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes së Bordit dhe që janë të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të Fondit dhe për mbarëvajtjen e veprimtarisë së tij;
 - e. nxjerr urdhra në përmbushje të kompetencave të tij me karakter ekzekutiv.
 - f. emëron dhe shkarkon punonjësit e Fondit Kombëtar për Tërmetet;
 - g. përmbush detyra dhe përgjegjësi të tjera, në përputhje me rregulloret e brendshme të Fondit.

KREU V
ADMINISTRIMI FONDIT

Neni 25
Operatori Teknik Ndërkombëtar

1. Fondi mund të delegojë menaxhimin dhe administrimin operacional pranë një Operatori Teknik Ndërkombëtar. Për përzgjedhjen e operatorit teknik ndërkombëtar duhet të plotësohen të paktën kriteret e mëposhtme:
 - a) Operatori Teknik Ndërkombëtar duhet të jetë një shoqëri sigurimi ose risigurimi nga vendet e OECD-së/BE-së dhe të ketë së paku nivel të cilësisë së kreditit A, sipas përcaktimit të agjencive kryesore klasifikuese. Për shoqëritë që nuk kanë shkallë krediti prej agjencive klasifikuese, por janë të licencuara dhe mbikëqyrura nga regjime mbikëqyrëse të barasvlefshme me Regjimin Aftësia Paguese II të Bashkimit Evropian, raporti i fundit i aftësisë paguese duhet të jetë mbi 175%.
 - b) Përvojë në sigurime/ risigurime dhe modelimin e rreziqeve të lidhura me katastrofat natyrore.
 - c) Personel të dedikuar dhe të trajnuar për të siguruar një shërbim të shpejtë dhe të saktë të trajtimit dhe pagesës të kërkesave për dëmshpërblim në rast të ndodhjes së ngjarjes së siguruar.
2. Fondi mund të bashkëpunojë me marrëveshje për realizimin e disa operacioneve teknike me një operator kombëtar ose ndërkombëtar, që kanë të bëjnë me:
 - a) mbledhjen e primit;
 - b) vlerësimin e dëmeve;
 - c) ndërmjetsimin për risigurim;
3. Procedura e përzgjedhjes, kriteret dhe tarifa e Operatorit sipas pikës 1, të këtij neni, përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 26
Regjistri i Sigurimit të Detyrueshëm për Tërmetet

1. Regjistri i Sigurimit të Detyrueshëm nga tërmetet është një bazë të dhënash sipas

ligjit për bazën e të dhënave shtetërore, i cili krijohet me qëllime grumbullimin dhe ruajtjen e informacioneve dhe të dhënave të nevojshme për ofrimin e sigurimit të detyrueshëm nga tërmetet.

2. Fondi Kombëtar për Tërmetet është përgjegjës për regjistrin dhe garanton që regjistri është i plotë, gjithëpërfshirës dhe i përditësuar në çdo moment.
3. Regjistri i sigurimit të detyrueshëm për tërmetet :
 - a) mbledh dhe ruan të dhënat e pronave të siguruara, dhe i lidh ato me të dhënat e mbledhura, sipas shkronjës “c”, të paragrafit 2 të këtij neni;
 - b) krijon një bazë të dhënash elektronike të nevojshme me qëllim ruajtjen e informacioneve të marra nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm nga tërmetet;
 - b) mbledh dhe ruan të dhënat që lidhen me policat e sigurimit të detyrueshëm nga tërmetet;

Neni 27

Menaxhimi dhe rrjeti i shitjeve

1. Këshilli i Ministrave përcakton agjentin për menaxhimin e shitjeve, komisionet përkatëse dhe procedurën për shitjen e policave të sigurimit të detyrueshëm nga tërmetet.
2. Polica e sigurimit gjenerohet përmes sistemit e-Albania.
3. Fondi Kombëtar për Tërmetet lidh marrëveshje me agjentin për realizimin dhe arkëtimin e shitjeve.

Neni 28

Risigurimi

1. Programi i risigurimit organizohet në baza vjetore në emër të Fondit Kombëtar për Tërmetet.
2. Përzgjedhja e risiguruesve kryhet sipas kritereve të përcaktuara me rregullore të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.
3. Përzgjedhja e risiguruesit/risiguruesve përjashtohet nga rregullat e prokurimit publik.

Neni 29

Shkëmbimi i informacionit dhe bashkëpunimi me autoritetet publike

Fondi Kombëtar për Tërmetet, për realizimin e funksioneve të caktuara me këtë ligj, shkëmben informacion me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Shërbimin Social Shtetëror, Njësitë e Qeverisjes Vendore, si dhe me autoritete të tjera.

Neni 30

Kontabiliteti dhe raporti financiar

1. Fondi Kombëtar për Tërmetet mban llogari e regjistra financiare, që në çdo kohë duhet të pasqyrojnë në mënyrë të saktë gjendjen financiare të fondit, në përputhje me ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” si dhe me standardet ndërkombëtare.
2. Fondi përgatit raportin dhe llogaritë financiare në fund të çdo viti financiar.
3. Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor.

Neni 31

Kontrolli

1. Pasqyrat financiare vjetore të Fondit Kombëtar për Tërmetet çertifikohen nga auditues të jashtëm të specializuar, që miratohen nga bordi drejtues.
2. Veprimtaria e Fondit auditohet nga auditues të brendshëm, që miratohen nga bordi drejtues.
3. Autoriteti i Mbykqyrjes Financiare mbikëqyr fondin kombëtar për Tërmetet, në kuptim të ligjit për sigurimet në Republikën e Shqipërisë.

Neni 32

Raportimi

1. Fondi Kombëtar për Tërmetet i raporton ministrit përgjegjës për financat dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Neni 33

Zbatimi

1. Subjektet që nuk paguajnë primin e sigurimi i nënshtrohen masave shtrënguese si më poshtë:
 - a. Nuk marrin shërbime katarstale
 - b. Nuk marrin shërbime nga e-albania
 - c. Nuk marrin shërbime nga QKB

KREU X
DISPOZITA TË FUNDIT DHE TRANZITORE

Neni 34
Dispozitë kalimtare

1. Anëtarët e Bordit Drejtues zgjidhen jo më vonë se 60 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
2. Brenda një muaji nga konstituimi/ zgjedhja e Bordit Drejtues, miratohet struktura e re organizative dhe rregulloret e përshkrimit të punës dhe ndarjes së funksioneve.
3. Buxheti për veprimtarinë e Fondit Kombëtar për Tërmetet mbulohet nga buxheti i shtetit, deri në momentin kur Fondi Kombëtar për Tërmetet të ketë të ardhura të mjaftueshme për vijmësin e skemës. Ministri përgjegjës për financat përcakton momentin e përfundimit të mubulimit të fondit nga Buxheti shtetit.
4. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë akte nënligjore në zbatim të nenit 4, pika 4 dhe nenit 16, pika 2 këtij ligji.

Neni 35
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Lindita NIKOLLA